

Të drejtat tuaja kur jeni në rajonin e policisë

NJË UDHËZUES PËR FËMIJËT DHE TË RINJTË

Kjo fletëpalosje ju jep informacion të rëndësishëm për të drejtat tuaja kur jeni në një rajon policie. Të drejtat janë liritë dhe mbështetjet që ne të gjithë kemi, të cilat mbrohen me ligj. Fëmijët nën 18 vjeç kanë disa të drejta të ndryshme nga të rriturit, kështu që kjo fletëpalosje shpjegon se çfarë të drejtash keni ju.


Njohja dhe kuptimi i të drejtave tuaja mund t'ju ndihmojë të dini se kur po trajtoheni në mënyrë të drejtë. Policia ka për detyrë t'ju mbrojtë nga dëmtimi dhe të kujdeset për mirëqenien tuaj gjatë kohës që jeni në rajonin e policisë, edhe nëse ka prova që sugjerojnë se mund të keni bërë diçka për të shkaktuar dëm.

Ju lutemi lexojeni këtë broshurë sa më shpejt që të mundeni.

Kjo do t'ju ndihmojë të merrni vendime kur jeni në një rajon policie. Personi që ju jep këtë fletëpalosje do t'ju ofrojë ndihmë për ta lexuar dhe kuptuar atë. Ai gjithashtu do t'ju pyesë nëse dëshironi një version tjetër të kësaj fletëpalosjeje, si p.sh. një në një gjuhë tjetër ose një që është më i lehtë për t'u lexuar.

1. **Ju keni të drejtë të dini pse policia po ju mban në rajonin e policisë.**


2. **Ju keni të drejtë të dini pse policia ju ka sjellë në rajonin e policisë.**



3. **Ju duhet t'i jepni policisë emrin, adresën, datën e lindjes dhe kombësinë tuaj nëse i dini këto. Këto janë të vetmet pyetje që duhet t'u përgjigjeni. Ju keni të drejtën të mos i përgjigjeni asnjë pyetjeje tjetër.**

4. **Ju keni të drejtën të njoftoni dikë që jeni në rajonin e policisë.** Policia do t'ju pyesë nëse dëshironi t'i tregoni dikujt se jeni atje. Ky mund të jetë dikush në familjen tuaj, partneri juaj, kujdestari juaj, miku juaj ose ndonjë person tjetër që njihni. Ju mund të mos lejoheni të flisni me këtë person. Nëse jeni nën 16 vjeç ose jeni nën një urdhër mbikëqyrjeje të detyrueshme, keni të drejtën të keni dikë me vete në rajonin e policisë. Ju keni të drejtën të vizitoheni nga prindi ose kujdestari juaj në rajonin e policisë.

5. **Ju keni të drejtën të njoftoni një avokat që jeni në rajonin e policisë.** Policia do t'ju pyesë nëse dëshironi t'i tregoni një avokati se jeni në rajonin e policisë. Ky mund të jetë avokati juaj ose do të thirret avokati i gatshëm një avokat tjetër për ju. Kjo është falas.



6. **Ju keni të drejtën të flisni me një avokat privatisht në çdo kohë.** Kjo është falas

7. **Ju keni të drejtën të keni një avokat të pranishëm nëse policia ju interviston.** Kjo është falas.

8. **Nëse jeni nën 16 vjeç, duhet të jetë i pranishëm një avokat kur ju interviston policia, përveç nëse kjo mund të rrezikojë dikë.** Nëse jeni 16 ose 17 vjeç dhe keni një urdhër mbikëqyrjeje të detyrueshme, duhet të jetë i pranishëm një avokat kur policia ju interviston, përveç nëse ka rrethana të jashtëzakonshme.

10. **Ju keni të drejtën për ushqim dhe pije.** Uji do t'ju sigurohet. Do t'ju ofrohet ushqim nëse jeni në rajonin e policisë për më shumë se katër orë. Policia duhet t'ju pyesë nëse keni ndonjë nevojë specifike dietike sa më shpejt që të jetë e mundur.

9. **Ju keni të drejtën për ndihmë mjekësore nëse jeni i sëmurë ose i plagosur. Kjo përfshin ndihmën për shëndetin tuaj mendor.** Policia do t'ju drejtojë pyetje në lidhje me shëndetin dhe mirëqenien tuaj për t'u siguruar që ju do të merrni përkujdesjen e duhur ndërsa jeni në rajonin e policisë. Është e rëndësishme t'i tregoni policisë nëse keni një problem mjekësor që mund t'ju prekë kur jeni në rajonin e policisë. Policia mund t'i kërkojë një infermiere ose mjek që t'ju kontrollojnë. Kjo është për t'u siguruar që do të merrni kujdesin e duhur ndërsa jeni në rajonin e policisë Policia duhet t'ju pyesë nëse keni nevojë të flisni me një mjek, infermiere ose profesionist tjetër të shëndetësisë.

Më shumë udhëzime...

Nëse keni nevojë për ndihmë shtesë

Ju mund të keni nevojë për ndihmë për të kuptuar se çfarë po ndodh kur jeni në rajonin e policisë. Nëse jeni 16 vjeç e lart, kjo ndihmë mund të jetë nga një person mbështetës i trajnuar i quajtur Personi i rritur i përshtatshëm. Kjo mund të jetë e nevojshme nëse keni një aftësi të kufizuar për të mësuar ose problem të shëndetit mendor. Nëse policia mendon se keni nevojë për ndihmën e një Personi të rritur të përshtatshëm, do t'ju sjellë një të tillë, edhe nëse nuk e kërkon.

Sjellja e një përkthyesi për t'ju ndihmuar

Është e rëndësishme që të kuptoni se çfarë po thuhet në rajonin e policisë. Nëse nuk flisni ose nuk kuptoni anglisht, policia do t'ju sjellë dikë që flet gjuhën tuaj. Ky person quhet përkthyes. Kjo është falas.

Marrja e ndihmës në komunikim

Shumë njerëz e kanë të vështirë të kuptojnë se çfarë po ndodh në rajonin e policisë. Policia duhet t'ju pyesë nëse keni nevojë për ndihmë ose nuk jeni i sigurt për ndonjë gjë. Ata duhet t'ju ofrojnë ndihmë për të lexuar nëse keni nevojë. Nëse jeni i shurdhër ose keni vështirësi të komunikoni qartë, policia do të sjellë dikë që t'ju ndihmojë. Ky mund të jetë një përkthyes i gjuhës britanike të shenjave ose një profesionist tjetër i përshtatshëm. Kjo është falas.

Nëse nuk jeni britanik

Nëse nuk jeni shtetas britanik, policia duhet t'ju ofrojë të kontaktojë me Komisionin tuaj të Lartë, Ambasadën ose Konsullatën, për t'u treguar se ku jeni dhe pse jeni në rajonin e policisë. Më pas, dikush mund t'ju vizitojë privatisht dhe të organizojë që një avokat të takohet me ju.

Çfarë ndodh nëse akuzoheni ose silleni në rajonin e policisë me urdhër?

Nëse akuzoheni për një vepër penale, mund t'ju lejojnë të largoheni ose mund të mbaheni në rajonin e policisë dhe të dërgoheni në gjykatë ditën vijuese të mundshme. Nëse jeni sjellë në rajonin e policisë me urdhër, mund të mbaheni dhe të dërgoheni në gjykatë ditën vijuese të mundshme. Në disa situata, mund t'ju lejohet të shkoni në shtëpi.

Sa kohë mund të mbaheni në paraburgim?

Policia mund t'ju mbajë në paraburgim deri në 12 orë pa ju akuzuar për vepër penale. Policia mund ta zgjasë këtë maksimum deri në 24 orë, por vetëm nëse një oficer i lartë i policisë është dakord me këtë. Ju keni të drejtën të thoni fjalën tuaj për këtë vendim, ose mund të zgjidhni që avokati juaj të flasë në polici për ju.

Si të shikoni dokumentet

Juve ose avokatit tuaj do t'ju jepet një shënim i provave të çështjes, nëse çështja juaj shkon në gjykatë. Kjo do t'ju lejojë juve ose avokatin tuaj të përgatitni mbrojtjen tuaj. Ju keni të drejtën që ky informacion të përkthehet, ose të paktën pjesët përkatese të dokumenteve të rëndësishme nëse nuk kuptoni anglisht.

Më shumë udhëzime...

Informacion në lidhje me të drejtën e aksesit të një avokat

- Policia do t'ju pyesë nëse dëshironi të flisni me një avokat. Policia do të kontaktojë një avokat për ju sa më shpejt të jetë e mundur.
- Juve ju lejohe të zhvillonit një bisedë private me një avokat në çdo kohë. Kjo mund të jetë në telefon, ose ai mund të vijë dhe t'ju vizitojë në rajonin e policisë.
- Bisedimi me një avokat është i zakonshëm dhe nuk bën të duket sikur keni bërë ndonjë gabim.
- Detyra e një avokati është të mbrojtë të drejtat tuaja dhe t'ju japë këshilla rreth ligjit.
- Ju mund të zgjidhni të flisni me një avokat që njihni ose me një avokat me të cilin mund të gjejë policia që të flisni - ky avokat quhet avokat i gatshëm. Avokati i gatshëm është i pavarur dhe nuk punon për policinë.
- Nëse policia ju interviston, ata do t'ju pyesin nëse dëshironi një avokat në dhomë me ju kur të zhvillohet kjo intervistë.
- Policia zakonisht nuk lejohe t'ju intervistojë pa një avokat nëse keni kërkuar që në dhomë me ju të jetë një avokat.
- Ju mund të ndryshoni mendje për të folur me një avokat dhe mund të kërkonti një avokat në çdo kohë. Tregojini policisë sa më shpejt të jetë e mundur dhe ata do të kontaktojnë një avokat për ju.
- Nëse avokati nuk vjen në rajonin e policisë kur ka thënë se do të vijë, ose ju nevojitet të flisni përsëri me avokatin, mund t'i kërkonti policisë që ta kontaktojë përsëri. Policia nuk ka asgjë në dorë se kur arrihet avokati në rajonin e policisë pasi ai të kontaktohet. Policia mund të ndajë mendimet dhe dëshirat tuaja me këtë avokat nëse ju dëshironi.

E drejta juaj për t'u ankuar

- Ju keni të drejtën të ankoheni për mënyrën se si jeni trajtuar nga policia.
- Nëse ankoheni për Policinë e Skocisë, kjo nuk do t'ju bëjë të dukeni keq.
- Ju mund të bëni ankesë kur jeni në paraburgim.
- Nëse dëshironi të ankoheni kur jeni në paraburgim, kërkonti të flisni me një inspektor ose me dikë të një rangu më të lartë.
- Nëse dëshironi të ankoheni pasi jeni liruar, mund të shkoni në çdo rajon policie.
- Nëse jeni lënduar ose plagosur nga një oficer policie gjatë arrestimit ose ndalimit nga policia, duhet të ankoheni pranë Departamentit të Standardeve Profesionale të Policisë së Skocisë.
- Për t'u ankuar telefononi numrin 101 ose shkoni në rajonin tuaj të policisë lokale.
- Ju gjithashtu mund t'i kërkonti dikujt tjetër të bëjë një ankesë për ju. Ky mund të jetë një prind, mik, partner ose dikush të cilit i besoni. Ju duhet t'u jepni atyre lejen tuaj me shkrim.

Kjo broshurë u prodhua në bashkëpunim nga anëtarët e STARR, hapësira e vetme e përzgjedhur e Skocisë për njerëzit me përvojë për kujdesin e sigurt, në partneritet me Qendrën e Fëmijëve dhe të Rinjve për Drejtësi (CYCJ) dhe Qeverinë Skoceze. "E drejta juaj për t'u ankuar" është përshtatur nga People First Scotland.

Për më shumë informacion dhe mbështetje vizitoni justtherightspace.org

© Crown copyright 2023